



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202000011/14

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për respektimin e të drejtave të shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me konventat dhe legjislacionin e brendshëm*

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
Drejtues Madhor Ardi Veliu
Tiranë

I nderuar z. Veliu,

Në ditën e parë të këtij fillim viti, Avokati i Popullit konstatoi e ndoqi me shqetësim problematikën e bërë publike në lidhje me dëbimin e shtetasit turk, H.Ç drejt Turqisë nga autoritetet e Policisë së Shtetit.

Rasti i dëbimit të shtetasit turk H.Ç, i cili kishte qenë i paraburgosur për afër 6 muaj në IEVP "Mine Peza", tërhoqi vëmendjen e mediave kombëtare dhe më gjerë, duke u bërë publik prej tyre, por edhe vëmendjen e europarlamentarëve të ndryshëm.

Në këtë kuadër, në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar me iniciativë rasti, me qëllim kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, përmes mbledhjes së informacionit nga institucionet shtetërore kompetente: Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, IEVP "Mine Peza", Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Rrethanat e çështjes

H.Ç, i datëlindjes **.**.**** ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet P.K.K Morinë në datë 05.07.2019, me pasaportën turke me numër *****, me të dhëna identifikuese të këtij shtetasi dhe ka dalë sërish nga P.K.K Morinë në drejtim të Kosovës më datë 05.07.2019, me të njëjtën pasaportë.

Më pas, ky shtetas ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet P.K.K Morinë me pasaportën turke me numër *****, në datë 08.07.2019 ora 00⁰⁰ dhe është ndaluar në Aeroportin e Rinasit më datë 08.07.2019, rreth orës 03³⁰ (orë e përcaktuar në procesverbalin e kapjes në flagrancë mbajtur nga punonjësit e policisë kufitare), në momentin që ka tentuar të udhëtojë me linjën Austrian Airlines në drejtim të Austrisë dhe më pas Kanadasë me pasaportën e tij turke dhe vizën kanadeze në brendësi të saj.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedimi penal nr.5246, datë 09.07.2019 në ngarkim të shtetasit H.Ç, për veprën penale të “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.1146, datë 11.07.2019 ka vendosur:

- vlerësimin si i ligjshëm i arrestit në flagrancë të personit nën hetim z.H.Ç.
- caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim z.H.Ç atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila me vendimin nr.555, datë 24.07.2019 ka vendosur:

Miratimin e vendimit nr.1146. akti datë 11.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke qenë në kushtet e paraburgimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka hetuar çështjen dhe e ka dërguar atë në gjykatë.

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nr.2933, datë 19.12.2019 është vendosur:

- Deklarimi fajtor i të pandehurit H.Ç për veprën penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 13 muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar të pandehurin me 8 muaj e 20 ditë burgim.
- Vuajtja e dënimit i fillon nga data e arrestimit datë 08.07.2019.
- Urdhërohet fshirja e vizës kanadeze me nr.***** me afat vlefshmërie nga data 05.09.2017-04.06.2021 e ndodhur në faqen numër 18 të pasaportës turke me nr.***** të shtetasit H.Ç e cila është tërësisht e falsifikuar.
- Prova materiale e sekuestruar me procesverbalin datë 08.07.2019 pasaporta turke me nr.***** t’i kthehet të pandehurit H.Ç.

Me vendimin nr.1016 Akti, datë 01.01.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur shuarja e masës së sigurimit personal “arrest në burg” vendosur me vendimin nr.1146 Akti, datë 11.07.2019 për shtetasin H.Ç. Organi procedues në datë 01.01.2020 ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal nr.1016, datë 01.01.2020 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shuarjen e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj shtetasit H.Ç.¹

Vendimi nr.2933, datë 19.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për deklarimin fajtor të shtetasit H.Ç për veprën penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal dhe vendimi nr.1016, datë 01.01.2020 i po kësaj gjykate ku është vendosur shuarja e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, kanë marrë formë të prerë në datë 06.01.2020, pasi nuk janë ankimuar.

Ndërkohë, po në datë 01.01.2020 nga IEVP “Mine Peza” lajmërohet Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë lidhur me ekzekutimin e vendimit të shuarjes së masës së sigurisë për shtetasin turk H.Ç dhe lënien e tij të lirë.

Pas njoftimit të kësaj drejtorie, nga pamjet filmike të kamerave të IEVP-së vihet re se shtetasi H.Ç është transportuar me makinën e policisë me targa “Policia 1605”, i shoqëruar nga 3 punonjës civilë të policisë, rreth orës 17⁰⁸ të datës 01.01.2020.

Brenda kësaj date ose më saktë pak orëve, janë kryer procedurat lidhur me pajisjen e tij me dokument nga Ambasada Turke, vendoset dëbimi, firmoset urdhri i dëbimit, bëhet ekzekutimi i menjëhershëm i tij dhe po brenda së njëjtës ditë, personi nisat me avion për në shtetin turk.

Hetimi administrativ

Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë i është kërkuar informacion i hollësishëm lidhur me dinamikën e ngjarjes, duke përfshirë arsyet dhe shkaqet ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë urdhri i dëbimit për këtë shtetas dhe është kryer ekzekutimi i menjëhershëm i tij, nëse ka pasur një kërkesë për azil nga shtetasi turk paraqitur autoriteteve shqiptare, arsyet për mosdhënien e mundësisë për të ushtruar të drejtën ligjore të ankimit administrativ dhe atij gjyqësor ndaj urdhrin të dëbimit, si dhe mosdërgimin e këtij shtetasi në Qendrën e Mbyllur në Karreç deri në ekzekutimin e urdhrin të dëbimit si detyrim ligjor i parashikuar në nenin 109, pika 2 të ligjit “Për të huajt”.

Në përgjigjet e saj, kjo drejtori paraqet se janë njoftuar më datë 01.01.2020 nga IEVP nr.302, “Mine Peza”, Tiranë nëpërmjet shkresës nr.01/5 prot., datë 01.01.2020 se me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.1016, datë 01.01.2020 është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i shtetasit H.Ç, lajmërim ky i kryer në bazë të nenit 139/pika 6 të ligjit “Për të huajt”.

¹ Në Ligjin Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar, Kreu I "Ekzekutimi i vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë", Neni 21 "Ekzekutimi i menjëhershëm" parashikohet se:

Ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit:

1. Vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurim me arrest për shkak tjetër.

2. Vendimet penale ndaj një personi me masë sigurimi me arrest ndaj të cilit jepet një dënim i barabartë ose më i vogël se koha e paraburgimit ose një lloj dënimi tjetër më të butë, duke u urdhëruar lirimi i menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurimi me arrest për shkak tjetër.....

Drejtoria referon se sipas verifikimeve të kryera për këtë rast me institucionin e IEVP 302 Tiranë, ka rezultuar se ky shtetas nuk ka bërë kërkesë për azil. Gjatë intervistimit të shtetasit në momentin që është pyetur nëse kishte depozituar kërkesë për azil në Republikën e Shqipërisë, ai është përgjigjur se, nuk kishte kërkuar azil dhe se kishte planifikuar të kërkonte azil në momentin që do të shkonte në shtetin kanadez. Duke qenë se tentativa për të udhëtuar në Kanada ka qene ne korrik 2019, mendojme se kjo përgjigje i referohet asaj periudhe kohore.

Sipas shpjegimeve me shkrim të kesaj drejtorie, shtetasi turk H.Ç më datë 08.07.2019 ora 14⁰⁰ është arrestuar në flagrancë për veprën penale “falsifikim i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal. Arrestimi i tij u krye pasi më datë 08.07.2019 rreth orës 03³⁰, është ndaluar në dalje të Republikës së Shqipërisë, nga punonjësit e Policisë Kufitare në P.K.K Rinas, pasi ka tentuar të kalojë kufirin shqiptar, duke udhëtuar me linjën ajrore “Austrian Airlines” me intenerar Tiranë-Vjenë-Toronto/Kanada, me pasaportën e tij turke me nr.*****, ku në brendësi të saj ndodhej një vizë kanadeze e dyshuar si e flasifikuar. Nga ana e tij është paraqitur si dokument udhëtimi pasaporta e tij turke me nr.***** dhe në brendësi të saj, në faqen numër 18 ndodhej një vizë kanadeze me nr.*****, me afat vlefshmërie nga data 05.09.2017-04.06.2021, e cila pas ekzaminimeve të kryera në laboratorin e ekzaminimit të dokumeneve në Rinas, ka rezultuar e falsifikuar.

Në zbatim të ligjit për të huajt nr.108/2013, neni 139/pika 6 ku citohet “institucionet e vuajtjes së dënimit, duhet të njoftojnë autoritetet përgjegjëse rajonale për kufirin e migracionin, 24 orë para liritimit të të huajve nga ky institucion”, më datë 01.01.2020, jemi njoftuar nga IEVP nr.302 Tiranë, mbi lirimimin e shtetasit të huaj H.Ç që mbahej në masën e sigurisë “arrest në burg”, pasi ndaj këtij shtetasi gjykata kishte dhënë vendim për shuarjen e masës së sigurimit dhe lirimimin e menjëhershëm të tij.

Pas kryerjes së procedurave përkatëse ky shtetas është marrë në dorëzim nga ana e drejtorisë, në ambientet e I.E.V.P. nr.302 Tiranë, ku është konstatuar se ai nuk posedonte një dokument të rregullt udhëtimi. Në fakt dokumenti i tij i udhëtimit ishte në posedim të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë². Për këtë arsye, është marrë kontakt me Ambasadën Turke në Tiranë, të cilët e pajisën këtë shtetas me dokument udhëtimi (leje kalimi).

Më tej në përgjigje sqarohet se, në zbatim të ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, neni 109/pka 1/gërma “a” “ka të dhëna se do të përdorë territorin e Republikës së Shqipërisë për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera” ndaj këtij shtetasi u lëshua “urdhër dëbimi” nr.2125, datë 01.01.2020 dhe në zbatim të nenit 112/pika 2 dhe nenit 4/pika 10, ku citohet “urdhri i dëbimit ekzekutohet menjëherë në rast se prania e tij përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike” të këtij ligji u ekzekutua largimi i tij nga territori i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet P.K.K Aeroporti Rinas.

Më tej po sipas këtyre shpjegimeve, transporti i shtetasit të sipërcituar, për në pikën e Kalimit Kufitar Rinas, është kryer me automjetin e DVKM Tiranë me targë Policia 1605, me drejtues mjeti Inspektor Çesk Ndoci, ndihmëspecialist i Seksionit të Migracionit të Parregullt dhe është shoqëruar nga shefi i Sektorit të DVKM Tiranë K/komisar Besnik Zela dhe Shefi i Seksionit të Migracionit të Parregullt, Komisar Ilir Zhupa. Shtetasi i sipërcituar, nuk e ka kundërshtuar urdhrin e dëbimit.

² Pasaporta është kthyer efektivisht me urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal datë 13.01.2020, ku organi procedues ka vendosur ekzekutimin e vendimit penal nr.2933, datë 19.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të dënuarin H.Ç., kthimin e pasaportës në adresën turke

Largimi i tij nga territori i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet P.K.K Aeroporti Rinas u ekzekutua menjëherë në zbatim të nenit 112/pika 2 “Urdhri i dëbimit ekzekutohet menjëherë në rast se prania përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike ...”. Këtij shtetasi i ndalohet hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë deri më datë 31.12.2025.

Duke qenë se vepra penale e kryer nga ky shtetas është një vepër penale që kryhet në kufi dhe mbulohet nga Policia Kufitare dhe Migracionit, në zbatim të nenit 4/pika 10 të ligjit për të huajt “Autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike është struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit”, ndaj ky vendim merret nga ky autoritet.

Nga drejtoria pretendohet se shtetasi turk e firmosi me vullnet të lirë urdhrin e dëbimit dhe nuk u shpreh kundër zbatimit të tij, nuk pranohet të ketë patur kërkesë për azil në vendin tonë nga ky shtetas, pasi kur është pyetur nga ana e tyre kërkesën për azil do ta paraqiste në Kanada.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.5246, datë 09.07.2019 në ngarkim të shtetasit H.Ç për veprën penale të “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave”, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal. Ky shtetas është hetuar me masë sigurimi personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin nr.1146 akti, datë 11.07.2019 (arrestuar në datë 08.07.2019). Në datë 27.09.2019 çështja penale në ngarkim të shtetasit H.Ç është përcjellë për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykim ky që ka përfunduar në datë 19.12.2019.

Nga ana e organit procedues në bazë të akteve të dosjes është kërkuar deklarimi fajtor i shtetasit turk H.Ç për veprën penale të parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal, duke e dënuar atë me 13 muaj burgim, kërkesë kjo e pranuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin penal nr.2933, datë 19.12.2019 (në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 8 muaj e 20 ditë burgim).

Me vendimin nr.1016 Akti, datë 01.01.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur shuarja e masës së sigurimit personal “arrest në burg” vendosur me vendimin nr.1146 Akti, datë 11.07.2019 për shtetasin H.Ç. Organi procedues në datë 01.01.2020 ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit penal nr.1016, datë 01.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shuarjen e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj shtetasit H.Ç. Ndërkohë që me urdhrin për ekzekutim të vendimit penal datë 13.01.2020 organi procedues ka vendosur ekzekutimin e vendimit penal nr.2933, datë 19.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të dënuarin H.Ç.

Me shkresën nr.02 prot., datë 01.01.2020 është dërguar urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit nr.1016 Akti, datë 01.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shuarjen e masës së sigurimit ndaj shtetasit H.Ç.

Konstatime

Në bazë të hetimit administrativ të mësipërm dhe dokumentacionit të përcjellë nga autoritetet e lartpërmendura, konstatohet se:

Nga organi procedues nuk është kërkuar largimi/dëbimi i shtetasit turk H. Ç nga territori i Republikës së Shqipërisë, pas vuajtjes së dënimit penal me burgim.

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është shprehur në vendim lidhur me largimin/dëbimin e shtetasit H.Ç nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me procedurën e ndjekur nga I EVP “Mine Peza”, 302 Tiranë për njoftimin për lirim të shtetasit të huaj H.Ç, shkresa nr.01/5 prot., datë 01.01.2020, ajo gjen mbështetje në pikën 6 të nenit 139 të ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Institucionet e vuajtjes së dënimit duhet të njoftojnë autoritetet përgjegjëse rajonale për kufirin dhe migracionin, 24 orë para lirim të të huajit nga ky institucion.”* Nga sa më sipër, del se koha e mjaftueshme sipas këtij ligji për të marrë masat e duhura nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin është 24 orë. Duket se në këtë rast ky afat nuk ka qenë i nevojshëm për këtë drejtori dhe janë marrë masat në një kohë shumë më të shpejtë.

Drejtorja Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë mohon të ketë patur një kërkesë për azil nga shtetasi turk, edhe pse në media kanë qarkulluar dhe janë bërë publike pamjet filmike në ambjentet e jashtme të kësaj drejtorie, ku dëgjohet zëri i këtij personi që thërret: “..azil, azil”.

Në bazë të ligjit nr.121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se:

“Azil” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve.”

“Kërkesë për azil” është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdo mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.”

Sipas Konventës të OKB-së “Mbi statusin e refugjatit” çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas. Kjo konventë përfaqëson dokumentin më të rëndësishëm ndërkombëtar për mbrojtjen e refugjatëve.

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për azil e të huajit apo personit pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, si pasojë e këtyre ngjarjeve, për arsye të kësaj frike.

Po ashtu, parimi i moskthimit është detyrim i autoriteteve për të mos kthyer a prapësuar, ekstraduar apo larguar jashtë territorit të saj personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes.³

³ Në këto raste:

- në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;
- në një shtet ku ka arsye të besueshme se azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Europiane apo në traktatet/konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;
- në një shtet ku ka arsye të besueshme se azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;

Ky parim mbështetet edhe nga neni 113 i ligjit “Për të huajt” ku përcaktohet:

“1. Nuk është subjekt i një urdhri dëbimi i huaji, i cili plotëson njërin nga kushtet e mëposhtme:.... d) ka arsye të bazuara për të dyshuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese;...”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në protokollin 7 të saj, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, parashikon shprehimisht se:

“Neni 1 Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve

- 1. Një i huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një shteti **nuk mund të dëbohet**, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:
 - a. të parashtrijë arsyet kundër dëbimit të tij,*
 - b. të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij, dhe*
 - c. të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa persona të caktuar nga ky autoritet.**
- 2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të renditura në paragrafin 1.a, b dhe c të këtij neni, kur ky dëbim **është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.**”*

Kjo konventë në kuptim të nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është pjesë e legjislacionit të brendshëm të vendit dhe zbatohet drejtëpërsëdrejti. Ndërkohë që përveç këtij parashikimi të shprehur në konventë, ligji nr.108/2013 “Për të huajt”, zbaton pikërisht parimin e shprehur në Konventë, duke trajtuar shkaqet për të cilat mund të lëshohen urdhrat e dëbimit, të drejtën e ankimit ndaj urdhrat të dëbimit dhe procedurën e ekzekutimit të urdhrave të dëbimit.

Në analizë të parashikimit të shprehur në Konventë dhe të ligjit shqiptar të sipërcituar, është e qartë se dëbimi mund të kryhet për një shkak të parashikuar shprehimisht në ligj, ndaj tij garantohet e drejta e ankimit dhe se përjashtimi nga ky rregull bëhet vetëm në një rast të mirëcaktuar në ligj: “nëse ai përbën rrezik për sigurinë kombëtare”. Në këtë rast neni 9, 109/d dhe 110 i ligjit përcakton se Ministri i Brendshëm është autoriteti përgjegjës për të përcaktuar se personi është një person me rrezikshmëri e për këtë shkak duhet të deklarohet person i padëshiruar, më pas të dëbohet nga territori. Ai nxjerr një urdhër të tillë dëbimi, pasi shkaqet për të vlerësuar nëse personi është apo jo person që ka rrezikshmëri për rendin dhe sigurinë kombëtare vlerësohen prej këtij të fundit, si autoritet me njohuritë e mirëpërcaktuara në ligj, por edhe në frymën e parashikimit të Konventës.

Në rastin objekt shqyrtimi, nga analiza e bërë kuadrit normativ por edhe vlerësimit të vetë tekstit të urdhrat të dëbimit të lëshuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, rezulton se ai është një masë ekstreme e marrë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar. Konkretisht, si edhe argumentuam më lart, të huajt mund të largohen vetëm për një shkak i cili duhet të jetë i parashikuar me ligj. Konkretisht, urdhri i dëbimit, parashikon se ai mbështetet në pikën 1/a të nenit 109 të ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, ku

ç) në shtetin e tyre të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) në një shtet të tretë, i cili mund ta kthejë ose ta dërgojë personin në një nga shtetet, sipas përcaktimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni.

përcaktohet si shkak dëbimi: “...kur i huajia) ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin Republikës së Shqipërisë dhe ka të dhëna se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera.” Lidhëza “dhe” përcakton se ligji shqiptar kërkon plotësimin e të dy kushteve në mënyrë kumulative për t’i dhënë të drejtë autoritetit shtetëror që të urdhërojë dëbimin e një personi.

Nga sa kemi trajtuar më sipër, nga të dhënat e faktit shtetasi H.Ç nuk ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra është e qartë se nuk plotësohet kushti i parë për të cilin ligji lejon dëbimin nga territori, konkretisht “*hyrja në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë*”. Nuk ka asnjë pretendim për hyrje të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Theksojmë se nëse një gjë e tillë do të ishte e vërtetë, ky veprim përbën vepër penale dhe është analizuar nga ana e prokurorisë në hetimin e çështjes në ngarkim të këtij shtetasi. Është e qartë se prokuroria nuk ka konkluduar që një e tillë të ketë ndodhur, pasi akuza për të cilin personi është gjykuar është një tjetër. Gjithashtu, nga dispozitivi i vendimit të gjykatës rezulton se dokumenti i udhëtimit pasaporta mbetet e vlefshme dhe i kthehet të pandehurit. Vlen të theksojmë se në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale çdo akt apo dokument i falsifikuar i cili është sekuestruar për efekt të kryerjes së veprës penale, asgjësohet. Fakti që gjykata ka disponuar vetëm për fshirjen e vizës kanadeze dhe kthimin e pasaportës së sekuestruar shtetasit H.Ç, tregon se pasaporta e tij në tërësi ishte një dokument i vlefshëm udhëtimi. Kjo konfirmon gjithashtu se ai kishte hyrë në Shqipëri në mënyrë të ligjshme.

Pra, nga vlerësimi i aktit të dëbimit rezulton qartë se ai nuk është bërë për një shkak të parashikuar në ligj, përse nuk plotësohen në mënyrë kumulative të dy kushtet për të cilat lejohet dëbimi. Por edhe nëse dëbimi do të ishte bërë për një shkak të parashikuar në ligj, përsëri ligji shqiptar njeh të drejtën e ankimit ndaj vendimit të dëbimit. (neni 110 i ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”).

Shtetasit turk nuk i është dhënë mundësia e deklarimit të largimit vullnetar brenda një afati të caktuar, as nuk është nxjerrë një urdhër largimi fillimisht nga kjo drejtori. Kështu, nëse shtetasit turk do t’i ishte dhënë kjo mundësi në bazë të ligjit, atëherë nuk do të ekzekutohej urdhri i largimit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Deklarimi i largimit vullnetar të të huajt merret në konsideratë nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin në vendosjen ose jo në urdhrin e largimit të masës kufizuese të ndalimit të hyrjes për të huajin, përjashtuar rastet kur, për interesa të rendit dhe sigurisë publike, ky deklarim nuk mund të merret në konsideratë.

Koordinimi gati i përsosur i institucioneve shtetërore për nxjerrjen e urdhrin të dëbimit dhe ekzekutimin e menjëhershëm të tij, për shtetasin H.Ç, është kryer brenda ditës së parë të vitit 2020, për më tepër ditë pushimi, kur përgjithësisht në raste të tilla, gjatë ditëve normale të punës, është tepër i vështirë bashkëpunimi ndërinstucional, brenda një kohe të shkurtër.

Mbetet ende e paqartë mënyra se si janë mbuluar shpenzimet e kostos së kthimit (bileta e udhëtimit) për shtetasin H.Ç. Ndërkohë që i huaji kundërshtonte largimin e tij drejt aeroportit dhe autoriteti rajonal për Kufirin dhe Migracionin Tiranë nuk disponon buxhet në dispozicion për kthimin e të huajve.

Shtetasi H.Ç dërgohet në Ambasadën e Turqisë në Tiranë për pajisjen me leje kalimi, ndërkohë që sipas disponimit të vendimit të gjykatës nr.2933, datë 19.12.2019 këtij shtetasi duhet t’i ishte kthyer pasaporta turke nr.*****, me kushtin e fshirjes

së vizës kanadeze me nr.***** të ndodhur në faqen numër 18 të saj. Rezulton se pasaporta e tij është e vlefshme, por ekzekutimi i këtij vendimi penal është bërë në datë 13.01.2020 nga organi procedues, 12 ditë pas dëbimit të tij nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Nuk evidentohet dhe as pretendohet në aktet dhe komunikimin për këtë rast se ky shtetas nuk duhet të priste ekzekutimin e vendimit penal të dhënë nga gjykata shqiptare për të.

Pavarësisht sa më lart, nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë është vendosur dëbimi i këtij shtetasi.

Por edhe në rastin e dëbimit, dërgimi i shtetasit H.Ç në Qendrën e Mbyllur në Karreç është një detyrim i parashikuar qartazi në nenet 109/pika 2 të ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar⁴ dhe i parespektuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, pavarësisht pretendimeve të ngritura nga kjo drejtori se nuk gjen zbatim në rastin konkret. Ky detyrim konfirmohet edhe në udhëzimin nr.293, datë 04.06.2015 të Ministrit të Brendshëm “*Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë*”.

Ekzekutimi i menjëhershëm i urdhrin të dëbimit nr.2125, datë 01.01.2020 nuk gjen asnjë mbështetje ligjore. Në nenin 112 të ligjit përcaktohen procedurat dhe mënyrat se si bëhet ekzekutimi i urdhrin të dëbimit. Ekzekutimi i menjëhershëm i urdhrin të dëbimit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërcënimin për rendin dhe sigurinë kombëtare që vjen si pasojë e pranisë së të huajit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga dokumentacioni dhe shpjegimet e dhëna nga drejtoria, nuk vërtetohet dhe as rezulton që të ketë ndonjë të dhënë se prania e shtetasit H.Ç në vendin tonë ka kërcënuar rendin dhe sigurinë kombëtare apo publike. Nuk janë vënë në dispozicion as dokumente nga agjencitë apo strukturat përkatëse ku të konfirmohet ky fakt.

Sipas nenit 4, pika 10 e ligjit “Për të huajt”, autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike është struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit. Sipas organizimit dhe funksionimit të Policisë së Shtetit, akteve nënligjore në fuqi për zbatim të ligjit “Për të huajt”, si dhe të gjitha praktikave që ndiqen tashmë prej më shumë se 7 vitesh nga dalja e këtij ligji, këtë autoritet e ushtrojnë Departamenti për Sigurinë Publike dhe ai i Policisë Kriminale dhe jo Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Mungesa e këtij dokumentacioni të vlerësimit për shtetasin H.Ç nëse përbën kërcënim për sigurinë publike, nga ana e kësaj strukture, është i kuptueshëm sepse në datë 01.01.2020 ka qenë ditë pushimi dhe asnjë sekretari, apo person përgjegjës për vlerësimin e kësaj çështjeje nuk ka qenë në punë.

Shtetasit H.Ç nuk i është mundësuar e drejta e ushtrimit të ankimit të këtij urdhri, e drejtë kjo e njohur në aktet ndërkombëtare (konventat që shteti ynë ka ratifikuar), legjislacionin e brendshëm, ligjin nr.108/2013 “Për të huajt”, të ndryshuar. Në vetë urdhrin e dëbimit, nr.2125, datë 01.01.2020 pika 5 e tij e parashikon një të drejtë ankimi,

⁴ 2.Në rast se i huaji bëhet subjekt i dëbimit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, sipas këtij neni, ai mbahet i ndaluar në një qendër të mbyllur, sipas nenit 121 të këtij ligji, derisa të ekzekutohet urdhri i dëbimit. Në rast të gjetjes së mundësive të tjera alternative, të zbatimit të masave të përkohshme, siç përcaktohen në seksionin IV të këtij kreu, këto të fundit kanë përparësi ndaj ndalimit.

por në mënyrë jo të saktë, pasi neni 122 i ligjit nr.108/2013 parashikon të drejtën e ankimit për urdhrin e ndalimit në qendrën e mbyllur dhe jo ndaj urdhrin të dëbimit. Në të njëjtin akt administrativ nuk është përcaktuar as afati kohor për ekzekutimin e kësaj të drejte, por parashikon vetëm afatin 0 ditë nga data e njoftimit, për largimin e tij nga territori i Republikës së Shqipërisë, pra është bërë ekzekutimi i tij i menjëhershëm.

Neni 110 e përcakton këtë si të drejtë për shtetasin e huaj dhe nga ana tjetër si një detyrim për zbatim nga autoriteti përgjegjës: *“1. I huaji ka të drejtë të ankimojë urdhrin e dëbimit të autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin, sipas legjislacionit në fuqi. 2. Deri në përfundimin e procedurës së ankimit, i huaji mbahet në kushtet e masave alternative të mbikëqyrjes ose në qendrën e mbyllur, në pritje të largimit të menjëhershëm, sipas urdhrin të nxjerrë për këtë qëllim.”*

E drejta për ushtrimin e ankimit, duke iu drejtuar gjykatës, është një e drejtë e lidhur me procesin e rregullt ligjor, njohur nga paragrafi 10 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut ku shprehimisht parashikohet: *“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.”* Neni 14, paragrafi 1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁵, neni 6, pika 1 e KEDNJ-së⁶ dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁷ konfirmojnë më tej këtë të drejtë.

E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe funksionimin e drejtësisë në vend. Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij.

Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa iu njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me nenin 6 të KEDNJ, duke nënkuptuar jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë mundësi.

Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor.

Gjithashtu sipas nenit 109, të ligjit 108/2013, të huajt i komunikohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton apo së paku në gjuhën angleze, se ndaj tij do të ekzekutohet masa administrative e dëbimit të marrë nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, duke i shpjeguar shkaku e nxjerrjes së urdhrin, datën dhe vendin ku do të ekzekutohet, mënyrën e transportimit të tij për në vendin e destinacionit dhe afatin e ndalimit të hyrjes. Rezulton se akti i dëbimit është i shkruar edhe në gjuhën anglaze,

⁵ “Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë.”

⁶ Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”

⁷ “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

veçse në gjuhën angleze nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me afatin brenda të cilit duhet të bëhet dëbimi. Në tekstin në gjuhën shqipe shënohet se ekzekutimi do të bëhet brenda 0 ditësh, por kjo shifër mungon në rreshtin në gjuhën angleze. Pra, edhe nga ana formale urdhri i dëbimit në kopjen e tij të komunikuar në institucionin tonë nuk plotëson urdhërimet e ligjit e për këtë shkak rezulton se këtij shtetasi i janë mohuar garancitë që Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe ligji ynë i jep atij. Nuk rezulton që teksti i aktit të ketë ndonjë shpjegim as në gjuhën shqipe dhe as në atë angleze se i dëbuari nuk kishte të drejtën e ankimit ndaj këtij urdhri. Në gjykimin e Avokatit të Popullit, të drejtat procedurale që iu njihen shtetasve apo të huajve në ligj duhet të zbatohen në mënyrë efektive, teksti i urdhrit të dëbimit veç referimit të bazës ligjore nuk ka asnjë shpjegim tjetër, si kërkohet nga ligji në lidhje me shkakun e nxjerrjes dhe as datën dhe vendin ku do të ekzekutohet apo mënyrën e transportimit të këtij shtetasi. Të tëra këto parashikime ligjore, nënkuptojnë që i dëbuari duhet të sqarohet në një gjuhë që ai kupton për të tëra sa më sipër në mënyrë efektive dhe se i takon organit që bën komunikimin që të provojë se këto veprime janë kryer. Është e vërtetë se në akt ka një nënshkrim që duhet të jetë i shtetasit turk H.Ç, por përmbajtja e urdhrit të dëbimit nuk provon se detyrimet e përcaktuara në nenin 109 si më sipër janë realizuar. Nuk rezulton as në akt e as nga shpjegimet ndonjë e dhënë e çfarëdolloji se shtetasi përbënte rrezik për sigurinë e vendit. Vlen të theksohet, se ky shtetas ka qenë i paraburgosur dhe se nuk ka pasur asnjë mundësi të ketë qenë largurvejimit policor. Dërgimi i tij në Qendrën e Mbyllur në Karreç do të vijonte të plotësonte kushtin e mbajtjes së personit në një qendër të mbyllur dhe nën vëzhgimin e policisë deri në kryerjen e procedurave sipas ligjit.

Gjithashtu, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë hetimit administrativ nga ana jonë janë kërkuar regjistrime të kamerave të sigurisë kryesisht të Komisarariatit Rinas për të hedhur poshtë pretendimin e bere publik ne media se ai shtetas ka kërkuar azil por kjo e drejtë është mohuar. Kemi kërkuar edhe disa akte me karakter rregullues. Të parat nuk janë vënë në dispozicion me pretendimin se administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe për të dytat ka pasur vonesa. Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit dhe njëkohësisht shmangia e burokracive në përcjelljen e materialeve dhe dokumenteve hetimore brenda strukturave të Policisë së Shtetit, duhet të konsiderohen parime të punës së përbashkët në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në mënyrë të përmbledhur, shkeljet konsistojnë në:

- mosmarrjen apo mosadministrimin e kërkesës për azil të shtetasit H. Ç dhe mosrespektimin e parimit të moskthimit në vendin e origjinës;
- nxjerrjen e urdhrit të dëbimit në kundërshtim me ligjin “Për të huajt”, si për sa i përket ekzistencës së shkakut të dëbimit, por edhe mënyrës së ekzekutimit të tij;
- mosrespektimin e procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligj për mënyrën e ekzekutimit të këtij dëbimi;
- mosdhënien e mundësisë për ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj urdhrit të dëbimit;

Për këto arsye, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se shkeljet e konstatuara të lidhura me të drejtat themelore të njeriut, të njohura prej dekadash nga aktet ndërkombëtare, e vendosin Shqipërinë në një pozitë aspak të favorshme, për më tepër në një moment kur kërkojmë integrimin e saj të shpejtë në Bashkimin Evropian.

Deklaratat e eurodeputetëve Ramona Strugariu dhe Marius Botoș, anëtarë të Delegacionit të BE-së për marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, përveç shprehjes së shqetësimit lidhur me respektimin e ligjit në rastin e dëbimit të shtetasit turk, bëjnë prezent se këto veprime mund të cenojnë perspektivën evropiane të vendit.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Analizimin me përparësi të procedurave të ndjekura dhe dokumentacionit të hartuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë për rastin e dëbimit të shtetasit turk H.Ç, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe njëkohësisht duke marrë masat administrative përkatëse apo çdo masë tjetër që do të konsideroni të përshtatshme.
- Marrjen e masave për hartimin e një udhëzuesi që të garantojë respektimin e të drejtave të shtetasve të huaj të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm të Republikës së Shqipërisë, si dhe mospërsëritjen në të ardhmen të këtyre rasteve në shkelje flagrante të tyre.
- Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të të gjithë strukturave të Policisë së Shtetit me institucionin e Avokatit të Popullit, duke shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e materialeve dhe dokumenteve hetimore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA